



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

amf

amf

amf

# ***STRATEGJI*** ***2018-2022***

***PËR AUTORITETIN E MBIKËQYRJES FINANCIARE***

*Janar 2018*



amf

amf

amf





*Ky material është një Sintezë e përmbledhur nga vëllimi i plotë i Strategjisë (Për Zhvillimin e AMF- së dhe Tregjeve nën Mbikëqyrje 2018-2022) miratuar nga Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare Nr 78, datë 28.04.2018 i cili përmban prioritetet dhe planet e veprimit për pesëvjeçarin e ardhshëm. Falenderojmë bashkëpunorët tanë: Grupin Keshillimor të konceptimit të Strategjisë, Partnerët Ndërkombëtarë, (Banka Botërore, FMN, SECO), Ministrinë e Financave dhe Operatorët e Tregjeve nën Mbikëqyrje, të cilët dhanë kontributin e tyre në hartimin e kësaj Strategjie.*

## **Përmbajtja**

1.	Hyrje.....	0
2.	Drejtimit dhe Projektet e Zhvillimit.....	4
2.1	Tregu i Siguri meve.....	5
2.1.1	Nxitja e besueshmërisë së konsumatorit.....	6
2.1.2	Përmirësimi i cilësisë dhe efektivitetit të mbikëqyrjes dhe rregullimit.....	7
2.1.3	Nxitja e zhvillimit të tregut të sigurimeve.....	16
2.1.4	Nxitja e stabilitetit afatgjatë.....	18
2.2	Tregu i letrave me vlere, fondeve të investimeve dhe pensioneve private suplementare.....	20
2.2.1	Eliminimi i kufizimeve që pengojnë zhvillimin e tregut.....	21
2.2.2	Forcimi i funksionit të mbikëqyrjes.....	23
2.2.3	Promovimi i tregjeve, me fokus te fondet e pensioneve.....	27
2.2.4	Edukimi financiar.....	28
2.2.5	Teknologjia.....	29
2.3	Infrastruktura ligjore e tregjeve.....	32
2.3.1	Kuadri i përgjithshëm.....	32
2.3.2	Tregu i sigurimeve.....	33
2.3.3	Vështrim krahasues në lidhje me problematikat e evidentuara më sipër.....	36
2.3.4	Tregu i Pensioneve Vullnetare.....	37
2.3.5	Tregu letrave me vlerë.....	38
2.3.6	Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive.....	40
2.3.7	Përmirësimi i kuadrit ligjor në fuqi.....	43
2.3.8	Konsolidimi i akteve dytësore.....	45





# *VIZIONI*

# 2022



*NGA TREGU MË I BRISHTË*

*DREJT TREGUT MË TË KONSOLIDUAR  
TË BALLKANIT PERËNDIMOR*



amf

amf

amf





## **ERVIN KOÇI,** **Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv**

*Rëndësia e prezantimit të Strategjisë për Zhvillimin e AMF-së dhe Tregjeve në Mbikëqyrje, 2018-2022, është një përvojë e suksesshme e këtij Autoriteti për të treguar një plan veprimi konkret dhe të zbatueshëm që do të ndërmarrë Autoriteti në pesë vitet e ardhshme.*

*Synimi ynë kryesor në hartimin e kësaj Strategjie është kombinimi i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit, dhe veçanërisht i tregjeve financiare jobankare, me përvojat integruese që po bën Shqipëria për anëtarësim në Bashkimin Evropian.*

*Fjalët kyçe që bashkojnë të gjithë Strategjinë janë Konsumatori dhe Investitori. Mbrojtja, fuqizimi dhe edukimi financiar i tyre do të jenë prioritetet tona. AMF synon që nëpërmjet ushtrimit të funksioneve të saj mbikëqyrëse dhe rregulluese të rivendosë besimin e konsumatorit/investitorit në tregjet financiare jobankare, me qëllim ruajtjen/sigurimin e integritetit të këtyre tregjeve si një faktor me ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik të vendit.*

*AMF ka vendosur disa elementë prioritarë si sfida të zhvillimit të saj afatmesëm:*

- *Zhvillimin e tregjeve financiare jobankare në Shqipëri dhe përparimin e tyre me ritëm të shpejtë duke synuar ritmet e rritjes së vendeve të rajonit;*
- *Përmirësimin e cilësisë dhe efektivitetit të mbikëqyrjes edhe nëpërmjet rritjes së kapaciteteve profesionale;*

- *Inovacioni teknologjik që do të lehtësojë nevojat në rritje të konsumatorit për realizimin e veprimeve online;*

- *Hartimin dhe miratimin e një kuadri ligjor të harmonizuar me direktivat e Bashkimit Evropian për tregjet financiare jobankare.*

*Strategjia 5-vjeçare, që po prezantojmë, përshkruan sfidat me të cilat përballlet zhvillimi i tregjeve, duke renditur disa nga drejtimit kryesore për periudhën 2018-2022.*

*Ne synojmë që implementimi i kësaj Strategjie të nxisë zhvillimin e një tregu konkurrent dhe eficient, duke krijuar njëkohësisht stabilitet afatgjatë, duke i dhënë mundësi krijimit të produkteve inovative.*

*Forcimi i funksionit mbikëqyrës në këto tregje do të ndikojë pozitivisht edhe në mbrojtjen e konsumatorit/investitorit.*

*Vlerësimet e bëra nga organizmat ndërkombëtarë për elementët e qeverisjes korporative në Shqipëri si transparencja, funksionimi dhe pavarësia e bordeve, sjellin në vëmendjen e AMF-së edhe forcimin e kuadrit mbikëqyrës dhe hartimin e politikave dhe rregulloreve të qarta që të trajtojnë këtë çështje, në mënyrë që të krijohet një kornizë solide për të mbrojtur investitorët.*

*AMF falenderon të gjithë partneret ndërkombëtar për mendimet e vëra, operatorët e tregjeve në mbikëqyrje, që kanë dhënë kontribut të vecantë në hartimin e kësaj strategjie dhe veçanërisht grupin keshillimor të ngritur nga AMF për bashkëpunimin frytdhënës dhe profesionalizmin e tyre.*





amf

amf

amf



---

## 1. Hyjre

Tregjet financiare jobankare kanë pësuar një zhvillim me ritme të ngadalta (modeste) të veprimtarisë së tyre. Këto tregje mbeten relativisht të kufizuara në raport me tregun bankar dhe me tregjet e rajonit dhe ofrojnë një kontribut modest në ndërmjetësimin financiar.

Paralelisht me zhvillimin e tregjeve është zhvilluar dhe procesi i mbikëqyrjes dhe ai rregullator. Me krijimin në vitin 2006 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), si bashkim i tre autoriteteve rregullatore mbikëqyrëse, përkatësisht për tregun e sigurimeve, tregun e letrave me vlerë dhe tregun e fondeve të pensioneve private vullnetare procesi i rregullimit dhe mbikëqyrjes përjetoi një zhvillim cilësor në drejtim të strukturimit dhe standardizimit.

Ndërkohë, **viti 2013** shënoi një tjetër moment të rëndësishëm me zhvillimin e Programit të Vlerësimit të Stabilitetit Financiar (FSAP) nga Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar. Në përfundim të këtij programi AMF-ja u përball me një program të gjerë masash dhe rekomandimesh për zbatim, të cilat synonin ta përafrojnë cilësinë e mbikëqyrjes dhe rregullimit me standardet ndërkombëtare.

**Viti 2014** konsiderohet si viti i forcimit të pavarësisë së AMF-së, me ndryshimet ligjore, duke e barazuar me institucionet e tjera financiare në vend. Pavarësisht këtyre përpjekjeve, si dhe mbështetjes së konsiderueshme të BB-së dhe FMN-së, procesi mbikëqyrës dhe rregullator nuk ndoqi më të njëjtin ritëm zhvillimin e tregjeve financiare nën mbikëqyrje. Për rrjedhojë, edhe sot AMF vijon të përballlet me mjaft sfida.

**Viti 2018** u përcaktua si viti i zhvillimit strategjik për AMF-në dhe njëherësh për tregjet. Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare miratoi Strategjinë 2018-2022. Ky dokument strategjik do të shërbejë si një pikënisje e rëndësishme e një faze të re të procesit mbikëqyrës e rregullator, atë të forcimit të vullnetit vendimmarrës në funksion të nxitjes së zhvillimit të tregjeve dhe forcimit të mbrojtjes konsumatore.

Nevoja e hartimit të një strategjie të qartë me theks të fortë në stabilizimin e tregjeve dhe rritjen e besueshmërisë së konsumatorit (në veçanti në tregun e sigurimeve) lindi si pasojë e mungesës së një plani veprimi për realizimin e këtyre objektivave në tre vitet e fundit.

Ky kuadër shërben për të konturuar punën dhe përpjekjet e AMF-së në harkun kohor 2018-2022. Në këtë kuptim, objektivat që AMF komunikon në vazhdimësi janë të natyrës afatmesme, por të orientuara drejt prioriteteve vjetore dhe një plani konkret veprimi, me qëllim rishikimin në varësi të dinamikës së zhvillimit të kuadrit institucional dhe nevojave të zhvillimit të tregjeve.

Vizioni udhëhiqet nga mbrojtja e konsumatorit, në drejtim të nxitjes së qëndrueshmërisë financiare dhe të zhvillimit të sigurtë të tregjeve financiare nën mbikëqyrje.

Janë përcaktuar disa drejtime të rëndësishme për zhvillim për periudhën afatmesme (2018-2022). Nisur nga madhësia dhe niveli jo i njëjtë i zhvillimit të tregjeve nën mbikëqyrje, kjo strategji është konceptuar, duke marrë në konsideratë nivelin e zhvillimit dhe nevojat për mbështetje të ndara sipas tregjeve.

---

## Tregu i sigurimeve

Në tregun e sigurimeve, këto drejtime zhvillimi i përkasin:

- (i) nxitjes së besueshmërisë së konsumatorit, nëpërmjet stabilizimit të tregut;
- (ii) përmirësimit të cilësisë dhe efektivitetit të mbikëqyrjes dhe rregullimit;
- (iii) nxitjes së zhvillimit të tregut; si dhe
- (iv) nxitjes së stabilitetit afatgjatë.

AMF e konsideron cilësinë e shërbimeve të ofruara nga operatorët dhe transparencën ndaj publikut, si shtyllën kryesore nga ku do projektohet zhvillimi i tregut. Nxitja e një tregu sigurimesh të shëndetshëm financiarisht, që përmbush detyrimet kundrejt konsumatorëve, përbën objektivin kryesor të kësaj strategjie.

Në planin afatgjatë, një strategji e tillë kapërcen kufijtë e tregut të sigurimeve dhe shndërrohet në një program kombëtar me përfitime të gjithëanshme, sidomos në uljen e frekuencës së aksidenteve.

Në përmbushje të misionit për nxitjen e zhvillimit të tregjeve financiare nën mbikëqyrje, AMF në periudhën afatmesme do të fokusohet dhe në zhvillimin e tregut të sigurimeve. Drejtimet kryesore në përmbushje të këtyre objektivave do të fokusohen në:

- (i) forcimin e zbatueshmërisë së produkteve të sigurimeve të detyrueshme;
- (ii) koordinimin e veprimeve me Ministrinë e Financave me qëllim përmirësimin dhe stabilizimin e regjimit fiskal që zbatohet në industrinë e sigurimeve;
- (iii) nxitjen e një tregu sigurimesh konkurrent dhe eficient; si dhe
- (iv) krijimin e lehtësirave për zhvillimin e kanaleve të reja të shpërndarjes dhe produkteve inovative.

AMF do të mbështesë inovacionet teknologjike dhe tendencat e reja që po shfaqen në tregun e sigurimeve, si mundësi të mira dhe metoda eficiente e me kosto të ulët të ndërmjetësimit financiar. Fokusi mbikëqyrës do të jetë në vendosjen e një ekuilibri midis mundësive që ofrojnë teknologjitë e reja dhe mbrojtja e konsumatorit, duke u kujdesur për ruajtjen e integritetit të tregut dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

## Tregu i kapitaleve si dhe fondet e investimit dhe pensionit

Tregjet e kapitalit dhe fondet e pensionit mbeten ende në fazat fillestare të zhvillimit, ndërkohë që dhe fondet e investimit, pavarësisht nivelit më të lartë të penetrimit, kanë kufizime në llojet e produkteve të ofruara apo dhe mundësive të investimit. Mungesa e zhvillimit të këtyre tregjeve lidhet dhe me nivelin ekonomik të vendit, por duke marrë parasysh historikun e vendeve të tjera të Evropës Lindore, AMF do të bazohet në reformat e tregut, reformat institucionale si dhe flukset e investimeve që lidhen me procesin e integritimit në BE.

AMF do të ketë një rol aktiv në ndërmarrjen e iniciativave dhe një koordinimi të tërësishëm me të gjithë faktorët institucionalë kombëtarë dhe ndërkombëtarë që ndihmojnë zhvillimin e tregut.

Veprimtaria e saj përsa i përket tregjeve të kapitaleve dhe fondeve të investimit dhe pensioneve do të fokusohet në pesë fusha kryesore, të gjitha me rëndësi për tregjet nën mbikëqyrje:

*Eliminimin e kufizimeve që pengojnë zhvillimin e tregut.*

*Forcimi i funksionit të mbikëqyrjes.*

*Promovimi i tregjeve.*

*Edukimi financiar.*

*Teknologjia (FINTECH)*

Bazuar në rëndësinë që ka qëndrueshmëria financiare, AMF ka përcaktuar disa prioritete strategjike në drejtim të administrimit të krizave, ngritjes së kapaciteteve për mbikëqyrjen e grupeve financiare dhe zhvillimin e mbikëqyrjes së konsoliduar si dhe ndërtimin e një mekanizmi për mbrojtjen e konsumatorëve ndaj falimenteve dhe daljeve nga tregu të operatorëve.

Vizioni pesëvjeçar i paraqitur në këtë dokument, mbështetur dhe në zhvillimin aktual të tregjeve financiare jobankare, na tregon nevojat për ndryshim në veprimtarinë e mëtejshme, me qëllim arritjen e objektivave dhe përballjen me sfidat e reja.





amf

amf

amf



*DREJTIMET DHE  
PROJEKTET E ZHVILLIMIT  
2018-2022*

amf

amf

amf



## 2.1. Tregu i sigurimeve

Kombinimi i një sërë faktorëve makro, mikro, legjislativ, rregullimi strukturor, koordinimi ndërinstitucional apo dhe fiskalë, e kanë lënë të pazhvilluar tregun e sigurimeve dhe përbëjnë ende sfida me të cilat tregu dhe rregullatori duhet të përballen.

Kapërcimi i këtyre sfidave dikton përcaktimin e disa drejtimeve të rëndësishme për zhvillim për periudhën afatmesme (2018-2022), si dhe identifikimin e disa projekteve, me anë të të cilave synohet përmbushja e misionit të AMF-së, në drejtim të nxitjes së qëndrueshmërisë financiare dhe të zhvillimit të sigurtë të tregjeve financiare nën mbikëqyrje për të:

- ▶ mbrojtur konsumatorët;
- ▶ nxitur transparencën dhe besueshmërinë në tregjet financiare, dhe siguruar respektimin e ligjit.

Këto drejtime zhvillimi i përkasin:

- ▶ nxitjes së besueshmërisë së konsumatorit, nëpërmjet stabilizimit të tregut;
- ▶ përmirësimit të cilësisë dhe efektivitetit të mbikëqyrjes dhe rregullimit;
- ▶ nxitjes së zhvillimit të tregut; si dhe
- ▶ nxitjes së stabilitetit afatgjatë.



### 2.1.1. Nxitja e besueshmërisë së konsumatorit



AMF e konsideron cilësinë e shërbimeve të ofruara nga operatorët dhe transparencën ndaj publikut, si shtyllën kryesore nga ku do projektohet zhvillimi i tregut. Nxitja e një tregu sigurimesh të shëndetshëm financiarisht, që përmbush detyrimet kundrejt konsumatorëve, përbën objektivin kryesor të kësaj strategjie.

#### (i) Pagesa e defiçitit të Fondit të Kompensimit

AMF do kërkojë me prioritet kryerjen e menjëhershme të pagesave të detyrimeve pezull të Fondit të Kompensimit, në zbatim të ligjit dhe si mesazh i qartë në mbrojtje të konsumatorit dhe të funksionimit të sistemit.

#### (ii) Stabilizimi i rezultateve të tregut të Jo-Jetës

Stabilizimi i aftësisë paguese të tregut dhe të operatorëve, që nuk i disponojnë treguesit është prioritet afatshkurtër i AMF-së, si një indikator kyç, i cili ndikon drejtpërdrejt në besimin e publikut.

#### (iii) Rritja e transparencës dhe përgjegjshmërisë së rregullatorit

Rritja e transparencës për operatorët në tregjet financiare jobankare dhe treguesit financiarë, do i shërbejë publikut të përzgjedhë më saktë operatorët e këtij tregu, si dhe do të krijojë një element kujdesi të shtuar të industrisë ndaj treguesve financiarë dhe performancës në pagesat e dëmeve. Gjithashtu, rritja e transparencës nga ana e vetë AMF-së për vendimet dhe mekanizmat në funksion të mbrojtjes konsumatore, përforcon përgjegjshmërinë e autoritetit rregullator.

#### (iv) Edukimi konsumator dhe nxitja e besimit

Bordi i AMF-së ka miratuar një Strategji për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit 2017-2020. Edukimi dhe mbrojtja e konsumatorit është element i rëndësishëm i rritjes së besimit në tregjet financiare. Zbatimi i kësaj strategjie pritet të japë efekte pozitive në ndërgjegjësimin e publikut për përfitimet nga sigurimet.





## 2.1.2. Përmirësimi i cilësisë dhe efektivitetit të mbikëqyrjes dhe rregullimit



Modernizimi i mbikëqyrjes dhe përafrimi me praktikat evropiane përbëjnë drejtimet strategjike të AMF-së dhe për këtë qëllim janë përcaktuar si prioritete:

### (i) Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse

Synimi kryesor është që AMF të ketë ekspertizë të brendshme të nivelit të lartë në fusha si: auditimi, sigurimet, kontabiliteti, aktuaristika, vlerësimi i aseteve, investimet, modelimet financiare, etj.

Kjo do të realizohet nëpërmjet rekrutimit të stafit të kualifikuar dhe rritjes së kualifikimeve të stafit të ri dhe atij aktual, për të rritur fleksibilitetin e tyre për t'iu përshtatur sfidave të reja dhe objektivave të institucionit, por dhe mbajtjen e motivuar në institucion të stafit të kualifikuar.

### (ii) Përputhshmëri me ICP-të

AMF synon përafrim sa më të plotë me ICP-të, si standardet kryesore, që përcaktojnë efektivitetin e një autoriteti rregullator, në linjë dhe me praktikat më të mira globale në mbikëqyrjen e sigurimeve.

FSAP 2013 evidentoi një nivel përafrimi në masën 42% me ICP-të, ku vetëm një standard nga 26 ishte plotësisht i harmonizuar me ICP-të. Nisur nga ndryshimet në legjislacion dhe dinamikën e institucionit vitet e fundit, do të ndërmerret një rivlerësim i përputhshmërisë me ICP-të, me synim hartimin e një plani veprimi për përafrim me këto standarde. AMF do të synojë një nivel përafrimi në masën 90% deri në fund të veprimit të strategjisë.

### (iii) Zbatimi i mbikëqyrjes me fokus rrezikun

Hyrja në fuqi e ligjit për sigurimin dhe risigurimin, në korrik 2014, ka mundësuar të gjithë kuadrin ligjor të nevojshëm për të mbështetur zbatimin e metodologjisë së mbikëqyrjes me fokus rrezikun në tregun e sigurimeve. Zbatimi i një metodologjie të tillë kërkon staf me përvojë dhe njohuri shumë të mira të biznesit të sigurimeve.

Objektivat kryesore që AMF ka identifikuar në këtë drejtim, janë:

- ▶ Krijimi i një bazë të dhënash me profilet e rrezikut të secilit sigurues, të kategorizuar sipas rrezikut, kompleksitetit të biznesit dhe impaktit të tyre në sistem, që do të mundësojë zbatimin efikas të metodologjisë me bazë rrezikun dhe shpërndarjen me efikasitet të burimeve mbikëqyrëse;
- ▶ Sistemi i Menaxhimit të Informacionit AMF in-Reg, përbën bërthamën e raportimit dhe të mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve dhe në kuadër afatgjatë do të jetë platforma e vetme e raportimit të subjekteve në AMF, për të gjitha tregjet e mbikëqyrura nga Autoriteti. Sistemi AMF In-Reg , i cili është vlerësuar nga FSAP-ja, si një sistem i nivelit të lartë, do të fillojë përgatitjen për vënien në zbatim të paketave të raportimit të Solvency II, AMF do krijojë dhe mbajë në vazhdimësi kapacitetet e nevojshme teknike për shfrytëzimin maksimal të platformës dhe do të zhvillojë një ndërlidhje të automatizuar për nevojat e mbikëqyrjes, të të gjitha bazave të të dhënave që AMF disponon.
- ▶ Ndërtimi i një sistemi të paralajmërimit të hershëm, nëpërmjet të cilit do të identifikohen fushat me rrezik të lartë në veprimtarinë e siguruesve dhe do të mundësohet identifikimi dhe shmangia e problemeve, përpara se ato të materializohen. Një sistem i tillë disponohet vetëm nga disa rregullatorë të konsoliduar dhe është gjithashtu, pjesë e strategjisë së parandalimit të krizave, që AMF ka konsultuar dhe me GKSF-në;
- ▶ Rritja e vazhdueshme e njohurive dhe kapaciteteve të punonjësve në lidhje me mbikëqyrjen me fokus rreziku, nëpërmjet trajnimeve të dedikuara.

(iv) Zbatimi i mbikëqyrjes së grupeve

AMF do hartojë kuadrin rregullator për mbikëqyrjen e grupeve, mbështetur nga një platformë raportimi dhe strukturë e dedikuar. Legjislacioni i sigurimeve i jep AMF-së mandat të qartë për mbikëqyrjen e grupeve, në frymën e direktivës së Solvency II, dhe në harmoni me ICP 23. AMF do të ndërtojë një strukturë të posaçme për mbikëqyrjen e grupeve dhe do të hartojë paketën e mbikëqyrjes dhe raportimit, në përputhje me kërkesat ligjore. Kjo është në linjë dhe me mbikëqyrjen me bazë rreziku, duke shpërndarë burimet në mënyrë më efikase, në varësi të kompleksitetit të siguruesit dhe impaktit që ka në treg.

(v) Forcimi i aspekteve të mbikëqyrjes së qeverisjes së shoqërive të sigurimit

AMF do rrisë fokusin mbikëqyrës në drejtim të aspekteve të qeverisjes së shoqërive të sigurimit, për t'u siguruar që ato janë në përputhje me standardet më të mira. AMF do hartojë udhëzues mbi praktikat më të mira të qeverisjes dhe do forcojë kriteret për pajtueshmërinë dhe kualifikimet e personave kyç të shoqërive të sigurimit.

Rritja e standardeve të qeverisjes së shoqërive të sigurimit pritet të ketë një ndikim pozitiv në ecurinë e këtyre shoqërive, dhe rrjedhimisht dhe të tregut. Gjithashtu theksi do jetë dhe mbi transparencën e shoqërive, në mënyrë që informacioni që ato publikojnë të jetë i plotë në përputhje me Direktivën për Shpërndarjen e Produkteve të Sigurimit Nr. EU 2016/97 në funksion të transparencës.

Për të qenë sa më afër këtyre standardeve, AMF do hartojë manuale ose udhëzues të qartë për kriteret që duhet të përmbushin personat kyç dhe proceset që siguresit duhet të zhvillojnë. Ky udhëzues do t'i shërbejë procedurave të licencimit dhe krijon lidhje midis funksionit mbikëqyrës dhe atij licencues. Në hartimin e këtyre praktikave AMF do të udhëhiqet nga parimi i proporcionalitetit, për të shmangur mbirregullimin dhe për të mbështetur fleksibilitetin operacional në raport me shkallën e rrezikut.

(vi) Solvency II

Në kuadër të integritimit evropian, AMF do ndërtojë një plan zbatimi të standardit Solvency II, i cili do konsultohet dhe me KE-në.

Në ndërtimin e këtij plani AMF do vlerësojë kapacitetet e tregut dhe të mbikëqyrjes, kohën e duhur të zbatimit, vlerësimin e kuadrit ligjor e rregullativ, si dhe periudhën e tranzicionit të zbatimit.

(vii) Rregullimi efektiv i tregut të sigurimit të detyrueshëm motorik

Strategjia e rregullimit të tregut të detyrueshëm motorik, duhet të synojë kalimin nga struktura aktuale e tregut, në një qasje, e cila bazohet mbi kriteret si më poshtë:

- ▶ E drejtë për konsumatorin;
- ▶ Efikase;
- ▶ Të krijojë incentiva për drejtim të kujdesshëm të automjeteve;
- ▶ Rezistente ndaj mashtrimeve;
- ▶ E qëndrueshme në kohë.

Objektivat kyç në zbatimin e kësaj strategjie janë si më poshtë:

- ▶ tarifimi me bazë rreziku, duke përfshirë zbatimin e sistemit bonus/malus;
- ▶ mundësimi i aksesit ndaj të dhënave cilësore për siguresit;
- ▶ ndërtimi i mekanizmave të duhur për grumbullimin e të dhënave;
- ▶ zvogëlimi dhe parandalimi i mashtrimeve në sigurime;
- ▶ forcimi i monitorimit të rezultateve financiare të siguresve;
- ▶ stabilizimi i mekanizmit të financimit të Fondit të Kompensimit dhe kryerjes së pagesave nga ky fond;
- ▶ ndryshime ligjore, të cilat do të adresojnë politikat e duhura të tarifimit me bazë rreziku dhe ofrojnë mbrojtje ndaj të siguruarve, duke forcuar rregullimin e këtij segmenti të tregut të sigurimeve në harmoni me direktivat e BE-së.

Në planin afatgjatë, një strategji e tillë kapërcen kufijtë e tregut të sigurimeve dhe shndërrohet në një program kombëtar me përfitime të gjithëanshme, sidomos në uljen e frekuencës së aksidenteve. Për referim, në shumë vende të BE-së një qasje e tillë strukturore ka rezultuar efektive në stabilizimin e tarifave dhe frekuencës së aksidenteve.

Duke analizuar komponentët e cituar më sipër në planin e sistemit aktual, lind nevoja për reforma të menjëhershme si më poshtë:

## ► Qendra e Sigurimit të Detyrueshëm Motorik

Zhvillimet në Qendrën e Sigurimit të Detyrueshëm Motorik, do synojnë krijimin e një sistemi efektiv qendror baze të dhënash me fokus tek:

Integrimi i një sistemi Bonus–Malus bazuar në të dhëna cilësore të dëmeve;
Ulja e numrit të të pasiguarve;
Monitorimi i luhatjes së tarifave nga këndvështrimi mbikëqyrës;
Vendosja e standardeve raportuese për tregun e sigurimeve;
Standardizim i raportimit në nivel tregu.

Objektivi kryesor është zhvillimi dhe zbatimi i sistemit Bonus-Malus. Sistemi qendror do të gjenerojë të dhëna të sakta mbi historikun e dëmeve për secilin pronar të automjetit me një nivel të qartë të përcaktuar Bonus-Malus. Historiku i dëmeve do jetë i lidhur me sistemin e shitjes.

Përsa i takon dizenjimit të Qendrës për këtë qëllim, AMF do të ndjekë një nga alternativat e mëposhtme:

- Integrimi në sistemin qendror të shitjeve të skemës për gjenerimin e klasës së Bonus-Malus; ose,
- Vënia në dispozicion e të dhënave mbi historikun e dëmeve për pronarin dhe drejtuesit e mjeteve. Qendra do të përdoret si mekanizëm i rëndësishëm në monitorimin e procesit të tarifimit. Sistemi do të mundësojë kontrollin, që zbatimi i tarifave të sigurimit të bëhet në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator ne fuqi, duke shmangur luhatjet e pambështetura në baza teknike. Gjithashtu, AMF do të shfrytëzojë Qendrën për të monitoruar më mirë shitjet e policave nga agjentët e autorizuar, duke u shndërruar në mekanizëm të rëndësishëm në luftën kundër informalitetit dhe mjeteve që qarkullojnë pa sigurim.
- Krijimi i një regjistri të dëmeve me sistemet e tregut në kohë reale, duke synuar krijimin e një baze cilësore të dhënash, që mund të përdoret për sistemin Bonus-Malus, për efekte të mbikëqyrjes aktuariale të provigjoneve dhe pagesave të dëmeve, apo dhe në krijimin e bazës së të dhënave kundër mashtrimit në sigurime, duke lehtësuar raportimin e dëmeve në kohë reale.
- Integrimi me bazat e të dhënave të aksidenteve dhe gjobave, me qëllim përdorimin e faktorëve të rrezikut në tarifim dhe rakordimin e informacionit të aksidenteve me dëmet e raportuara në regjistrin qendror.

## ► **Ulja e numrit të mjeteve të pasiguruara**

Deficiti i krijuar i Fondit të Kompensimit dhe dinamika e mjeteve të pasiguruara në vite, kërkojnë ndërmarrjen e disa hapave nga AMF në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për zgjidhjen e këtij problemi, i cili ndikon direkt në qëndrueshmërinë financiare të skemës së Fondit të Kompensimit në të ardhmen dhe performancën e tregut të sigurimeve.

Më poshtë jepen disa veprime të identifikuar për të adresuar problematikën me mjetet e pasiguruara:

- Krijimi i një njësie ose funksioni të dedikuar, i cili do të ketë një mandat të qartë për të ndërtuar dhe ndjekur një plan veprimi për uljen e numrit të mjeteve të pasiguruara. Kjo njësi do të ketë si objektiv uljen nën 10% të numrit të mjeteve të pasiguruara brenda një harku kohor pesëvjeçar. Struktura do të ketë burime të mjaftueshme njerëzore dhe mbështetje teknologjike.
- Bashkëveprimi me strukturat e policisë për uljen e numrit të mjeteve që qarkullojnë pa sigurim dhe ashpërsimi i sanksioneve kundrejt këtij fenomeni. Ndryshimet e viteve të fundit i kanë ashpërsuar gjokat për drejtuesit e mjeteve motorike, që nuk janë të pajisur me policë sigurimi. Gjithsesi, mbetet ende shumë për tu bërë dhe AMF do vijojë të bashkëpunojë në mënyrë të vazhdueshme me strukturat e policisë për të zbatuar me rigorozitet këtë mekanizëm, duke shfrytëzuar integritet në sistemet TI, tashmë funksionale prej vitesh.
- Bashkëveprimi dhe shkëmbimi i informacionit periodik me policinë dhe DPSHTR-në, me qëllim krijimin e një baze cilësore të dhënash mbi mjetet që qarkullojnë dhe që paguajnë taksat e sigurimit. Qëllimi i këtij bashkëveprimi është krijimi i një baze cilësore të dhënash, të cilat i shërbejnë të tre institucioneve dhe njëkohësisht evidentojnë mjetet, të cilat qarkullojnë pa policë sigurimi ose që nuk paguajnë taksat e qarkullimit. Në këtë mënyrë, autoritetet do jenë në gjendje të koordinojnë veprimet për të luftuar këto fenomene, të cilat i shkaktojnë dëme financiare të gjithë sistemit.
- Ndërlidhje me pikat e kolaudimit në kohë reale, në mënyrë, që mjetet gjatë kolaudimit të verifikohen online në sistemin e shitjeve, nëse janë të pajisur me policë të vlefshme sigurimi. Automatizimi i procesit dhe mos lëshimi i çertifikatës së kontrollit teknik, nëse në sistemin online nuk rezulton të ketë policë sigurimi të vlefshme, është një masë e domosdoshme. Në këtë mënyrë, arrihet një objektiv tepër i rëndësishëm në luftën kundër mjeteve të pasiguruara, pasi garantohet barazimi i numrit të mjeteve që paguajnë taksat me mjetet e siguruara.

---

## ► Sistemi Bonus-Malus

AMF do bëjë të detyrueshëm me ligj zbatimin e sistemit Bonus-Malus. Zbatimi i një sistemi të tillë do jetë kërkesë e detyruar për operatorët që shkruajnë sigurim të detyrueshëm motorik, rrit konkurrueshmërinë e operatorëve në treg, krijon më shumë aftësi për kompanitë që të zgjedhin klientë më të mirë, ndoshta duke rezultuar dhe në kosto më të ulëta në periudhën afatgjatë.

Sistemi do reflektojë specifikat e tregut vendas dhe do jetë subjekt i një analize periodike aktuariale për të vlerësuar efektivitetin e tij. Hartimi i një sistemi optimal do zhvillohet duke analizuar specifikat e tregut dhe konkretisht frekuencën e aksidenteve në mënyrë që të ndërtohet një sistem i ekuilibruar financiarisht dhe që i shërben qëllimit. AMF do kryejë një simulim të sistemit të përzgjedhur para se të fillojë zbatimin praktik të tij.



## ► Dematerializimi i TPL

Dematerializimi i TPL mbyll ciklin e një sistemi eficient të produktit TPL e brendshme, ku prova e sigurimit është numri unik i gjeneruar nga Qendra e Informacionit, duke eliminuar përfundimisht të gjitha praktikat e paligjshme që hasen në treg, si shitjet jashtë sistemit apo dhe falsifikimet e policave. Kombinuar me masat e ndërmarra për uljen e numrit të pasiguarve nëpërmjet integriteteve në nivel sistemesh TI, rezultatet pritet të jenë pozitive në drejtim të rritjes së kontratave të regjistruara në sistem, uljes së informalitetit dhe numrit të pasiguarve, duke zgjidhur çështjet e ardhshme me Fondin e Kompensimit, si dhe duke krijuar një ambient të përshtatshëm për rritje të cilësisë së shërbimit dhe incentivave teknologjike.

Ekzistenca e marrëveshjeve me institucionet përkatëse dhe zhvillimet e deritanishme TI, mundësojnë zhvillimin e këtij komponenti, pasi AMF të bëjë një vlerësim për zbatimin dhe amendimin e ligjit për sigurimin e detyrueshëm. Gjithashtu, një koordinim me autoritetet fiskale, policinë dhe DPSHTRr-në, është i domosdoshëm për të zhvilluar mekanizmin e kontrolleve dhe zbatimin e formatit të ri.





## ► Mekanizmi i Fondit të Kompensimit

Mosrespektimi i kërkesave ligjore në fuqi për pagesat e dëmeve, objekt i Fondit të Kompensimit, ka krijuar ndër vite një defičit të konsiderueshëm. AMF ka identifikuar veprimet e mëposhtme për krijimin e një mekanizmi të qëndrueshëm, në funksion të përmbushjes në kohë dhe në masën e duhur të detyrimeve ndaj konsumatorëve:

Sigurimi i financimit të qëndrueshëm të Fondit të Kompensimit. Fondi i Kompensimit duhet të ketë gjithmonë një minimum ligjor të disponueshëm në çdo kohë, për pagesat ndaj përfituesve.

Forcimi me ligj i sanksioneve dhe masave në rast të mospërmbushjes së detyrimeve nga operatorët e tregut. AMF duhet të marrë më shumë kompetenca dhe masa shtrënguese në forcimin e sanksioneve kundrejt Byrose për Fondin e Kompensimit, duke përshkallëzuar masat, në rastin e mospagesës së dëmeve. Përforcimi i rolit mbikëqyrës kundrejt BSHS-së dhe forcimi i rolit vendimmarrës të AMF në përcaktimin e masës së Fondit të Kompensimit. AMF do krijojë mekanizma të qartë dhe transparentë vendimmarrjeje, sidomos në rastet e pamjaftueshmërisë së Fondit të Kompensimit.

Ndryshimet në ligjin e ri duhet të përcaktojnë qartë transparencën dhe llogaridhënien e BSHS-së në lidhje me Fondin e Kompensimit. AMF do përcaktojë me ligj një minimum kërkesash për transparencë nga ana e BSHS-së, sikurse zbatohen në rastin e shoqërive të sigurimit. Për rrjedhojë, disa elementë të transparencës dhe llogaridhënies, që do sanksionohen me ligj, janë (i) kërkesa për publikime të detajuara mbi ecurinë e pagesave, kontributeve, si dhe përmbushjen e detyrimeve të FK-së, përfshi dhe publikimin e pasqyrave të audituara të BSHS-së, veçanërisht për FK; (ii) forcimi i rolit të auditit të brendshëm dhe të qeverisjes së BSHS-së; dhe (iii) detyrimi për krijimin nga BSHS të një baze të dhënash elektronike, subjekt auditimi të pavarur dhe inspektimi të vazhdueshëm nga AMF. Nga ana tjetër, AMF do forcojë kërkesat për informim dhe raportim nga vetë AMF në lidhje me Fondin e Kompensimit.



### 2.1.3. Nxitja e zhvillimit të tregut të sigurimeve



Në përmbushje të misionit për nxitjen e zhvillimit të tregjeve financiare nën mbikëqyrje, AMF në periudhën afatmesme do të fokusohet dhe në zhvillimin e tregut të sigurimeve. Drejtimet kryesore në përmbushje të këtyre objektivave do të jenë si më poshtë:

(i) Forcimi i zbatueshmërisë së produkteve të sigurimeve të detyrueshme.

AMF do koordinojë me Ministritë e linjës dhe Shoqatën e Siguruesve, forcimin e zbatueshmërisë të produkteve të sigurimeve të detyrueshme.

Kuadri ligjor shqiptar ka përcaktuar një sërë produktesh sigurimi si të detyrueshme. Sidoqoftë nuk ekziston asnjë studim, që të analizojë shkallën e zbatueshmërisë së këtyre sigurimeve dhe vlerësohet që penetrimi i pjesës më të madhe të këtyre produkteve të jetë i ulët.

AMF, në bashkëpunim me Shoqatën e Siguruesve, do kryejë një analizë të sigurimeve të detyrueshme në Shqipëri, me qëllim adresimin e faktorëve kryesorë që ndikojnë në penetrimin e ulët, ku fokusi do jetë në dobësitë e kuadrit ligjor por edhe në elementë të tjerë, që pengojnë zbatimin e këtyre produkteve. Gjithashtu do të identifikohen dhe produkte të tjera të sigurimit, të cilat duhet të jenë të detyrueshme, nisur nga niveli i përgjegjësisë dhe përfitimit publik që paraqesin, krahasuar me tregje të ngjashme me Shqipërinë.

Veçanërisht i rëndësishëm këtu është forcimi i kuadrit ligjor për përgjegjësitë në nivel kombëtar, që do të shërbejë si një incentivë e rëndësishme për zhvillimin e produkteve të sigurimit të përgjegjësive.

(ii) Koordinimi i veprimeve me Ministrinë e Financave me qëllim përmirësimin dhe stabilizimin e regjimit fiskal që zbatohet në industrinë e sigurimeve.

AMF do koordinojë veprimet me Ministrinë e Financave dhe Shoqatën e Siguruesve, me qëllim përmirësimin dhe stabilizimin e regjimit fiskal që zbatohet në industrinë e sigurimeve. Regjimi fiskal është një komponent i rëndësishëm për zhvillimin e tregut, pasi një regjim fiskal i qëndrueshëm ndikon pozitivisht në planet e shoqërive për investime, apo tërheqjen e investitorëve të huaj. Për këtë është e rëndësishme, që të realizohet një analizë apo studim i regjimit aktual fiskal, identifikimin e atyre incentivave fiskale që mund të kenë impakt të rëndësishëm në zhvillimin e tregut të sigurimeve (përfshirë këtu dhe një vlerësim të përafërt të efektit mbi buxhetin e shtetit), krahasimin me vendet e rajonit. Pas kryerjes së kësaj analize do të hartohen propozime konkrete për t'ia paraqitur qeverisë për ndryshimet e nevojshme të kuadrit fiskal, i cili duhet të jetë i qëndrueshëm në kohë.

(iii) Koordinimi i veprimeve me Ministrinë e Financave, me qëllim identifikimin e incentivave fiskale për produktet e Jetës.

Industria e sigurimit të Jetës në Shqipëri ngelet shumë e pazhvilluar. Rrjedhimisht bëhet i rëndësishëm hartimi i propozimeve për incentiva të ndryshme fiskale që mund të zbatohen për të zhvilluar produktet e Jetës. Duke qenë se këto produkte kanë një nivel të ulët penetrimi, gjykohet që dhe impakti në buxhetin shtetit të jetë i ulët.

(iv) Nxitja e një tregu sigurimesh konkurrent dhe eficient.

AMF do bashkëpunojë ngushtë me institucione si BSH dhe Autoriteti i Konkurrencës, për eliminimin e të gjitha pengesave në konkurrencën e lirë si dhe rritjen e transparencës për kategori të caktuara produktesh vullnetare, të cilat lidhen me produktet bankare (si sigurimi i pronës për efekt kredie). Gjithashtu, rritja e standardit të shërbimit ndaj klientëve, transparencës dhe eliminimi i nënsigurimit, gjatë shitjes së këtyre produkteve, rrjedhimisht do të ketë impakt pozitiv për gjithë industrinë.

(v) Krijimi i lehtësirave për zhvillimin e kanaleve të reja të shpërndarjes dhe produkteve innovative.

Shoqëritë e sigurimeve kanë kosto të larta në lidhje me shpërndarjen e produkteve të tyre, duke ndikuar ndjeshëm në nivelin e fitimit të tyre. Për këtë bëhet i rëndësishëm lehtësimi i zhvillimit të kanaleve të reja, si shpërndarja nëpërmjet mënyrave digjitale apo dhe përdorimi i kanaleve të tjera, për të promovuar e zhvilluar produktet e sigurimeve (jo vetëm ato produkte që lidhen me kreditë e bankave). Disa produkte me kosto të ulët si shëndeti në udhëtim, do të lejohen të shiten tërësisht në mënyrë digjitale, nisur nga raporti kosto/çmim i lartë. Në këtë mënyrë do të krijohen incentiva për zhvillime teknologjike apo ulje të kostove nëpërmjet teknologjisë, gjë që më tej mund të shndërrohet në avantazh strategjik në zhvillimin e produkteve eficientë të mikrosigurimit. Gjithashtu, dematerializimi i sigurimit të detyrueshëm motorik pritet të ndikojë pozitivisht në eficientësinë e kanaleve të shpërndarjes dhe inovacionit.

## 2.1.4. Nxitja e stabilitetit afatgjatë



Pjesë e misionit të AMF-së është të kontribuojë në nxitjen e qëndrueshmërisë financiare. Bazuar në rëndësinë që ka qëndrueshmëria financiare dhe në rekomandimet që lindin nga planet e posaçme të veprimit të hartuara nga GKSF, AMF ka përcaktuar disa drejtime strategjike, si më poshtë:

(i) Zhvillimi i një strategjie për administrimin e krizave, mbështetur mbi protokolle të qarta për parandalimin e krizave; përballjen me krizën; dhe eliminimin e pasojave të krizës, shoqëruar me fleksibilitetin e vendimmarrjes në situata emergjence. Kjo strategji do mbështetet me krijimin e funksioneve dhe kapaciteteve të nevojshme për identifikimin e rreziqeve, të bashkëveprimit të tyre, si dhe efekteve të tyre ndërmjet tregjeve të mbikëqyrura nga AMF, me fokus hartën makro të rreziqeve që ndërveprojnë në tregjet e mbikëqyrura nga AMF.

(ii) Ngritja e kapaciteteve për mbikëqyrjen e grupeve financiare dhe zhvillimi i mbikëqyrjes së konsoliduar në bashkëpunim me BSH, bazuar në një kuadër të qëndrueshëm dhe të mirëstrukturuar.

(iii) Ndërtimi i një mekanizmi për mbrojtjen e konsumatorëve ndaj falimenteve dhe daljeve nga tregu të operatorëve.

---

Legjislacioni në fuqi, në rast falimenti të një siguruesi, i cili shkruan biznes në sigurimin e detyrueshëm motorik, sanksionon që pagesat e pashlyera nga portofoli i tij, i transferohen siguruesve të tjerë që janë në treg, por nuk ka zhvilluar mekanizmin e financimit dhe të funksionimit të kësaj kërkesë ligjore. Defiçiti i krijuar nga Fondi i Kompensimit dhe situata e brishtë financiare e tregut të Jo-Jetës, bëjnë që sistemi të mos disponojë kapacitete ligjore, rregullatore dhe zbatuese për t'u përballur me një faliment të mundshëm.

Shumë vende të BE-së kanë krijuar mekanizma mbrojtjeje për situata të tilla, ku industria financon një fond të veçantë, të monitoruar nga Autoriteti Rregullator dhe që ndikon në zbutjen e situatave, që pasojnë falimentet në treg. Një praktikë e tillë i shërben rregullatorit dhe tregut si mekanizëm për rritjen e besimit ndaj konsumatorit, pasi një faliment, i cili lë një numër të madh policmbajtësish të pashlyer, dëmton imazhin dhe besimin e konsumatorit ndaj sistemit në tërësi, duke u shndërruar në barrierë serioze për zhvillimin e tregut. Kjo situatë mund të perceptohet negativisht dhe nga konsumatorët e tregjeve të tjera financiare nën mbikëqyrjen e AMF-së, pasi lidhet direkt me besimin e publikut tek Autoriteti rregullator. AMF do të nxisë iniciativa ligjore, për të përcaktuar funksionimin dhe financimin e një mekanizmi të tillë.



## 2.2. Tregu i letrave me vlerë, фондеве të investimeve dhe pensioneve private suplementare



Tregjet e letrave me vlerë në Shqipëri mund të konsiderohen ndër më pak të zhvilluarit në rajon. Një treg kapitalesh i pazhvilluar ndikon negativisht dhe në zhvillimin e фондеве të investimit dhe фондеве të pensionit privat. I vetmi komponent që ka njohur një zhvillim më të madh është sektori i фондеве të investimit, por dhe kjo ka qenë e ndikuar kryesisht nga politika të aktorëve specifikë të sektorit financiar.

Mungesa e zhvillimit të këtyre tregjeve lidhet dhe me nivelin ekonomik të vendit, por sikurse përmendet dhe në një raport të FMN-së, faktorë të rëndësishëm për zhvillimin e tregjeve në vendet e Evropës Lindore, që janë tashmë në BE, ishin reformat e tregut dhe reformat institucionale si p.sh listimi i detyrueshëm i shoqërive shtetërore që privatizoheshin, reformat e pensioneve si dhe flukset e investimeve që lidheshin me futjen në BE. Pavarësisht këtyre reformave, eksperiencia e këtyre vendeve tregon që sfidat kanë qenë të shumta, duke filluar nga qeverisja e dobët e shoqërive, standardet e papërshtatshme të raportimit apo mungesa e një ratings të besueshëm për letrat me vlerë.

Edhe zhvillimi i tregjeve të pensioneve private në vendet e Evropës Lindore lidhet kryesisht me pjesëmarrjen e фондеве private të pensionit tek skema e kontributeve të detyrueshme. Analiza e mësipërme tregon që një pjesë e mirë e faktorëve që do të ndikonin pozitivisht në zhvillimin e tregjeve të kapitaleve, apo dhe të фондеве, janë jashtë autoritetit të AMF-së. Megjithatë ngelen disa drejtime ku AMF do të fokusohet në mënyrë që të ndihmojë zhvillimin e qëndrueshëm të këtyre tregjeve, si më poshtë:

- ▶ Eliminimi e kufizimeve që pengojnë zhvillimin e tregut;
- ▶ Forcimi i funksionit të mbikëqyrjes;
- ▶ Promovimi i tregjeve;
- ▶ Edukimi financiar; si dhe
- ▶ Teknologjia.

Në zbatimin e strategjisë së saj AMF do të marrë parasysh dhe raportet dhe dokumentat që janë hartuar nga konsulentët e pavarur, në kuadër të projekteve të mbështetura nga Banka Botërore dhe Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështje Ekonomike (SECO).

## 2.2.1. Eleminimi i kufizimeve që pengojnë zhvillimin e tregut



Pavarësisht përmirësimeve të vazhdueshme që i janë bërë kuadrit ligjor dhe atij fiskal për fondet e investimeve dhe fondet e pensioneve private, ka shumë elementë të këtij kuadri që mund të ndryshohen për të nxitur zhvillimit e tregjeve.

Ambienti fiskal ku operojnë fondet e pensionit nuk ka qenë favorizues për zhvillimin e tyre, përkundrazi, ka ndikuar negativisht, ku veçanërisht anëtarët individualë të fondeve, pra ata që nuk janë pjesë e skemave profesionale, janë të disavantazhuar fiskalisht. Përfitimet e pensionit privat taten, ndërsa për një periudhë të gjatë kontributet për fonde private të pensioneve nuk u konsideruan si të zbritshme fiskalisht. Edhe pas kalimit të legjislacionit përkatës për njohjen e kontributeve për pensionet si të zbritshme, ka vështirësi praktike në rastin e anëtarëve të fondeve të pensionit që nuk janë pjesë e skemave profesionale për të njohur si të zbritshme këto kontribute.

Një tjetër problematikë lidhet me llojet e fondeve. Ligji nr. 10198 “Për fondet e investimit” lejon krijimin e fondeve të mbyllura. E vetmja mënyrë që të blejnë dhe të shesin fonde investorët pas ofertës fillestare, është vetëm në tregun sekondar. Në përgjithësi kuadri rregullator e vështirëson krijimin e shumë llojeve të fondeve, të cilat mund të kenë një nivel më të lartë rreziku, po që mund t’i shiten një audience me njohuri më të mira financiare (p.sh shoqëri tregtare, shoqëri sigurimi, etj.). Edhe rregulloret e likuiditetit dhe investimit për fondet nuk janë të diferencuara sipas tipit të fondit, që është dhe kjo një pengesë për zgjerimin e alternativave të investimit.

Për të adresuar problemet e mësipërme është e rëndësishme që të ndërmerren hapat e mëposhtëm:

- ▶ i) Optimizimi i kuadrit fiskal që rregullon fondet e pensioneve.
- ▶ ii) Përshtatja e rregulloreve dhe politikave të AMF-së në mënyrë që të lejohet krijimi i llojeve të reja të fondeve.
- ▶ iii) Eliminimi i pengesave strukturore për zhvillimin e tregut.
- ▶ iv) Komunikimi i vazhdueshëm me palët e interesuara.

#### **(i) Optimizimi i kuadrit fiskal që rregullon fondet e pensioneve.**

Është e rëndësishme që të optimizohet kuadri fiskal për fondet e pensioneve, së pari për të eliminuar çdo impakt negativ financiar mbi kontribuuesit, po njëkohësisht për të sugjeruar dhe incentiva fiskale që ta çojnë përpara industrinë. Çdo propozim duhet shoqëruar me një analizë të detajuar për impaktin mbi buxhetin e shtetit dhe ekonominë e vendit, në mënyrë që t'a bëjë më eficient procesin e negociimit me institucionet përkatëse (Ministria e Financave, Drejtoria e Tatimeve).

#### **(ii) Përshtatja e rregulloreve dhe politikave të AMF-së në mënyrë që të lejohet krijimi i llojeve të reja të fondeve.**

Është e rëndësishme që kuadri rregullator të lejojë një gamë më të gjerë fondesh investimi, shoqëruar kjo me forcimin e kapaciteve mbikëqyrëse për t'iu përgjigjur këtyre zhvillimeve. Rregulloret e investimit dhe likuiditetit duhet të përshtaten në mënyrë të tillë që të ketë rregulla të veçanta për lloje të ndryshme fondesh. Gjithashtu, në hartimin e këtyre rregulloreve duhet patur parasysh, që këto rregullore t'i japin një nivel fleksibiliteti të arsyeshëm subjekteve për format e investimeve, në mënyrë që të rriten kthimet për anëtarët e fondeve.

Ky do të jetë një katalizator i rëndësishëm për zhvillimin e tregut dhe do të ndikojë pozitivisht në rritjen e mundësive për investime, që është një nga dobësitë kryesore të tregut në Shqipëri.

#### **(iv) Komunikimi i vazhdueshëm me palët e interesuara**

Është e rëndësishme që AMF të mbajë një komunikim të vazhdueshëm jo vetëm me shoqëritë që operojnë aktualisht në treg, po dhe me shoqatat e ndryshme (shoqatat që mbledhin operatorët e tregut, dhomat e tregtisë, etj. për të identifikuar nevojat për përmirësime në kornizën rregullatore apo veprime të ndryshme që AMF mund të ndërmarrë për të zhvilluar tregun. Si pjesë e këtij komunikimi duhet të jetë dhe organizimi i konferencave apo seminareve të ndryshme informative për temat më të rëndësishme për tregun. Gjithashtu, konsolidimi i gjithë kuadrit rregullator (ligje, rregullore, urdhëresa) në një botim të vetëm do të ndihmojë në lehtësimin e këtij komunikimi, pasi do të shtojë nivelin e transparencës ndaj palëve të interesuara.



## 2.2.2 Forcimi i funksionit të mbikëqyrjes



Pavarësisht synimit për të nxitur zhvillimin e tregjeve, AMF do të jetë gjithmonë e vëmendshme ndaj qasjes që subjektet nën mbikëqyrje do të kenë ndaj klientëve. Në përgjithësi forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të AMF-së do të ndikojë pozitivisht dhe në mbrojtjen e konsumatorit.

Zhvillimi i tregut të fondeve të investimeve (po dhe atij të pensioneve) do të sjellë një rritje të llojeve por dhe të kompleksitetit të produkteve, që do të ofrohen nga këto fonde. Kjo sjell nevojën për investim në kapacitete mbikëqyrëse në AMF, në mënyrë që institucioni t'i paraprijë zhvillimit të tregut.

Aktualisht tregu i kapitaleve në Shqipëri ngelet i pazhvilluar, ndërkohë që dhe llojet e investimeve nga fondet e investimit dhe të pensioneve nuk paraqesin një larmi të madhe. Rrjedhimisht dhe kapacitetet mbikëqyrëse të AMF-së (qoftë si numër stafi apo përvojë dhe trajnime) i përgjigjen nivelit aktual të zhvillimit të tregjeve, por do të jenë të pamjaftueshëm në rast se tregjet nën mbikëqyrje do të zhvillohen.

Kjo do të kërkojë gjithashtu një zgjerim të aktiviteteve të përditshme të AMF-së, veçanërisht nëse do të ketë zhvillim të tregut të kapitaleve, kryesisht përsa i përket mbrojtjes së investitorëve, si objektivi kryesor, po dhe për t'u siguruar që tregjet janë transparentë, eficientë dhe të mbrojtura nga manipulimet.

AMF do të ketë në fokus punën kërkimore, e cila është shumë e rëndësishme për të mbështetur veprimtarinë e institucionit.

Tregjet nën mbikëqyrjen e AMF-së janë shumë të ndërthurura me ato nën mbikëqyrjen e Bankës së Shqipërisë. Bashkëpunimi AMF-Bankë e Shqipërisë është i domosdoshëm për të patur një mbikëqyrje efektive dhe gjithëpërfshirëse. Ndonëse bashkëpunimi mes dy institucioneve nuk ka munguar, mungon një marrëveshje e re bashkëpunimi që të reflektojë dinamikën e reja të tregut, po dhe ato që priten të vijnë në rast të zhvillimeve të mëtejshme.

Bazuar dhe mbi përvojën e vendeve të tjera, një nga sfidat më të mëdha që do të ketë AMF në momentin që tregjet e kapitalit do të marrin hov do të jetë problematika në nivelin e qeverisjes korporative në Shqipëri. Sipas një vlerësimi të bërë nga BERZH-i në mars të vitit 2017 elementë të qeverisjes korporative në Shqipëri si transparenca, funksionimi dhe pavarësia e bordeve, apo kontrollet e brendshme vlerësohen me "Dobët".

Kjo problematikë mund të ketë një ndikim të madh negativ përsa i përket besimit, që investitorët mund të kenë te shoqëritë që mund të emetojnë obligacione korporative apo dhe aksione. Gjithashtu dobësitë në qeverisjen korporative në shoqëritë që emetojnë letra me vlerë mund të sjellin situata ku dëmtohen interesat e mbajtësve të aksioneve/obligacioneve.

***Aktivitetet kryesore ku do të fokusohet AMF në kuadrin e forcimit të mbikëqyrjes janë:***

- (i) Ngritja e kapaciteteve të AMF-së nëpërmjet trajnimit të stafit aktual apo punësimit të personave me eksperiencë profesionale (qoftë dhe staf i huaj që mund të angazhohet në mënyrë të përkohshme) me fokus tek funksioni i mbikëqyrjes.
- (ii) Aplikimi i metodave bashkëkohore të mbikëqyrjes.
- (iii) Duke konsideruar problematikat që paraqiten në qeverisjen korporative në Shqipëri, është shumë e rëndësishme që të hartohen politika dhe rregullore të qarta që të trajtojnë këtë çështje, në mënyrë që të krijohet një kornizë solide për të mbrojtur investitorët.
- (iv) Finalizimi i marrëveshjes së re të bashkëpunimit me Bankën e Shqipërisë për rritjen e bashkëpunimit në mbikëqyrjen e tregjeve financiare, me fokus në ato tregje ku shihet një integrim më i lartë i subjekteve nën mbikëqyrjen e AMF-së me ato nën mbikëqyrjen e Bankës së Shqipërisë.
- (v) Forcimi i mbikëqyrjes ndaj operatorëve të tregut për t'u siguruar që ata zbatojnë rregullat dhe praktikën më të mira ndërkombëtare në shitjen e produkteve dhe që klientët marrin informacionin e duhur në momentin e blerjes.

*(i) Ngritja e kapaciteve të AMF-së nëpërmjet trajnimit të stafit aktual apo punësimit të personave me eksperiencë profesionale (qoftë dhe staf i huaj që mund të angazhohet në mënyrë të përkohshme) me fokus te funksioni i mbikëqyrjes.*

Zhvillimi i tregjeve do të sjellë një rritje të llojeve të subjekteve nën mbikëqyrjen e AMF-së, si dhe një larmi më të madhe në format e investimit nga këto subjekte. Për përballimin e këtyre sfidave do të ketë nevojë për një program ngritjeje kapacitetesh për AMF-në dhe veçanërisht për stafin që do të ketë përgjegjësi për mbikëqyrjen e tregjeve.

Gjithashtu duhen identifikuar organizata rregullatore simotra në vende të tjera apo organizata të tjera ndërkombtare që mund të ndihmojnë funksionin e mbikëqyrjes, jo vetëm në ngritjen e kapaciteve, por edhe në trajtimin e rasteve specifike (p.sh prospekte komplekse) si dhe finalizimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit, ku të specifikohet në mënyrë konkrete lloji i bashkëpunimit.

Duke ndjekur hapat e mësipërm, AMF do të ketë mundësi t'i përgjigjet në kohë zhvillimeve në treg. Nevoja për rritjen e kapaciteteve do të përkthehet dhe në nevojë për shtimin e stafit që të përballojë punën në rritje. Për këtë duhet kryer një analizë në AMF nëse buxheti i institucionit në të ardhmen do të jetë në gjendje që të përballojë këtë rritje të kapaciteteve (koston e trajnimeve, rritjes së stafit apo marrjes së ekspertëve të përkohshëm).

*(ii) Aplikimi i metodave bashkëkohore të Mbikëqyrjes.*

Elementë të tjerë që do ndikojnë pozitivisht në rritjen e kapaciteve të AMF-së janë zbatimi i plotë i mbikëqyrjes me bazë rreziku, pasi rrit besueshmërinë tek rregullatori dhe institucionet financiare. Aplikimi i mbikëqyrjes me bazë rreziku do të kërkojë dhe ndërtimin e metodologjive për vlerësimin (scoring) të rrezikut dhe ndërtimin e hartave të tij që do të shërbejnë për të pasur një qasje më të fokusuar në mbikëqyrje.

Bazuar dhe mbi eksperiencën e rregullatorëve të vendeve të tjera si dhe sugjerimet e dhëna nga konsulentët e AMF-së, është e rëndësishme që brenda funksionit të mbikëqyrjes të krijohet një ndarje e qartë mes monitorimit dhe inspektimit të tregut, ndonëse ndërveprimi mes tyre duhet të ngelet gjithmonë i fortë.

Me rritjen e aktivitetit të operatorëve të tregut, apo futjen e operatorëve të rinj, AMF duhet të jetë gati që të aplikojë atë që quhet “mbikëqyrja e mbështetur mbi bazat e të dhënave” (data driven supervision), që është tashmë në fokus dhe të rregullatorëve të vendeve të zhvilluara.

*(iii) Duke konsideruar problematikat që paraqiten në qeverisjen korporative në Shqipëri, është shumë e rëndësishme që të hartohen politika dhe rregullore të qarta që të trajtojnë këtë çështje, në mënyrë që të krijohet një kornizë solide për të mbrojtur investitorët.*

Në rast se do të kemi emetim të letrave me vlerë ndaj publikut, bazuar dhe në përvojën e rregullatorëve të tjerë, AMF-së do t'i duhet të sigurohet vazhdimisht që shoqëritë që do të emetojnë letrat me vlerë i përmbahen standardeve më të mira të qeverisjes korporative. Për këtë AMF duhet të mbështetet mbi Objektivat dhe Parimet e Rregullimit të Letrave me Vlerë të publikuara nga IOSCO (IOSCO principles).

---

*(iv) Finalizimi i marrëveshjes së re të bashkëpunimit më Bankën e Shqipërisë për rritjen e bashkëpunimit në mbikëqyrjen e tregjeve financiare, me fokus në ato tregje ku shihet një integrim më i lartë i subjekteve nën mbikëqyrjen e AMF-së me ato nën mbikëqyrjen e Bankës së Shqipërisë.*

Zhvillimi i tregjeve dhe ndërthurja gjithmonë e më e madhe e tregjeve nën mbikëqyrjen e AMF-së me ato nën mbikëqyrjen e Bankës së Shqipërisë e bën të domosdoshëm thellimin e bashkëpunimit mes të dy institucioneve, ku marrëveshja e bashkëpunimit do të shërbejë si kornizë udhëzuese.

AMF do të vazhdojë komunikimin me Bankën e Shqipërisë në mënyrë që kjo marrëveshje të realizohet sa më shpejt, si dhe që pikat e marrëveshjes të adresojnë jo vetëm çështjet aktuale, po dhe ti paraprijnë zhvillimeve të mundshme në industri.

*(v) Forcimi i mbikëqyrjes ndaj operatorëve të tregut për t'u siguruar që ata zbatojnë rregullat dhe praktikën më të mira ndërkombëtare në shitjen e produkteve dhe që klientët e marrin informacionin e duhur në momentin e blerjes.*

Është shumë e rëndësishme, që AMF të rrisë vëmendjen në këtë aspekt të operimit të fondeve të investimit dhe pensioneve, por edhe operatorët e rinj që do të futen në tregjet nën mbikëqyrje, për t'u siguruar që klientët kanë marrë informacionin e duhur bazuar mbi praktikën më të mira. AMF do të ketë në fokus të mbikëqyrjes së saj metodat që përdorin operatorët e tregut për të shitur produktet tek klientët. Për këtë, AMF do të shqyrtojë përmbajtjen e materialeve të marketingut që përdorin operatorët e tregut, për t'u siguruar që ato përmbajnë gjithë informacionin e duhur, monitorimin e fushatave të marketingut të operatorëve, apo dhe realizime të inspektimeve të tipit “mystery shopping”, për të parë në realitet si ndodh shitja e një produkti nga këto fonde.



### 2.2.3. Promovimi i tregjeve, me fokus te fondet e pensioneve



AMF do të përpiqet që të ndihmojë në promovimin e tregjeve nën mbikëqyrje, gjithmonë brenda kornizave institucionale. Fokusi i këtyre aktiviteteve do të jetë tregu i fondeve të pensioneve vullnetare, jo vetëm për shkak të penetrimit të ulët të këtyre fondeve, po dhe për shkak të impaktit pozitiv që zhvillimi i këtyre fondeve do të jepte për vendin.

AMF, në bashkëpunim me shoqëritë administruese të fondeve të pensionit, duhet të ngrëjë një plan pune për rritjen e ndërgjegjësimit mbi avantazhet e pensioneve private vullnetare, që mund të përfshijë realizimin e konferencave dhe aktiviteteve periodike që rrisin vizibilitetin e industrisë në publik.

## 2.2.4. Edukimi financiar

Një tjetër aspekt frenues për zhvillimin e tregjeve është dhe niveli i ulët i njohurive financiare tek individët (financial literacy), që në Shqipëri është më i ulët se pjesa më e madhe e vendeve të rajonit. Edhe përqindja e popullsisë në Shqipëri që përdor sistemin financiar (financial inclusion) rezulton të jetë më e ulët se rajoni. Kjo ndikon negativisht në ndërgjegjësimin e individëve për nevojën e një pensioni privat vullnetar, në qasjen e tyre ndaj produkteve që ofrohen nga fondet e investimit apo dhe më vonë në qasjen ndaj tregut të kapitalit.

AMF do të angazhohet në ndërtimin e iniciativave konkrete, me impakt afatgjatë, në bashkëpunim dhe me Bankën e Shqipërisë, për edukimin financiar në Shqipëri. Kjo duhet të përfshijë jo vetëm iniciativa afatshkurtra (fushata ndërgjegjësimi) po dhe përshtatjen e kurrikulave në sistemin shkollor parauniversitar, që duhet të jetë fokusi kryesor. Për këto aktivitete do të shërbejë si udhërrëfyes dokumenti i Strategjisë dhe Plani i Veprimit për “Rritjen e Besimit të Konsumatori/Investitorit në Tregjet nën Mbikëqyrje”, dokument ky i aprovuar në 2017.



## 2.2.5. Teknologjia



Zhvillimet e shpejta teknologjike duhet të jenë në fokusin e punës mbikëqyrëse të AMF-së, si nga pikëpamja e përdorimit të teknologjisë për të bërë me eficient aktivitetin mbikëqyrës, ashtu dhe në përgatitjen e stafit të AMF-së për të përballuar sfidat aktuale por edhe zhvillimet e ardhshme në teknologjinë që përdoret nga subjektet nën mbikëqyrje.

(i) Përdorimi i teknologjisë nga AMF si një instrument për të mbështetur funksionet e saj.

(ii) Adresimi i sfidave që lindin nga rritja e përdorimit të teknologjisë nga subjektet që operojnë në treg.

(i) *Përdorimi i teknologjisë nga AMF si një instrument për të mbështetur funksionet e saj.* Përvoja e sektorit privat, duke përdorur si referencë shoqëritë ndërkombtare të auditimit, ka treguar se aplikimi i teknologjisë për të automatizuar proceset e punës, pavarësisht vështirësive fillestare në zbatim, ka patur rezultate pozitive jo vetëm në lehtësimin e punës, po dhe mbi të gjitha në standardizimin e proceseve dhe produkteve të punës së stafit të mbikëqyrjes.

(ii) *Adresimi i sfidave që lindin nga rritja e përdorimit të teknologjisë nga subjektet që operojnë në treg.* AMF i mirëpret zhvillimet teknologjike që lehtësojnë punën e subjekteve që operojnë në treg, por edhe të klientëve, por sidoqoftë do bëjë përpjekjet e duhura në mënyrë që të ketë kapacitetet e duhura për të mbikëqyrur mënyrën si aplikohen këto teknologji.

---

Një ndër elementët që po sheh një zhvillim të shpejtë në botë por edhe në Shqipëri është përdorimi i teknologjisë për të promovuar produktet apo për të arritur te klientët, pa patur nevojë për zyra fizike. AMF do të shtojë vëmendjen ndaj platformave që ofrojnë tregti online të instrumentave financiare (forex, aksione, etj). Për këtë do të kërkohet bashkëpunimi me Bankën e Shqipërisë si edhe me institucionet ligjzbatuese.

Për këtë shihet e rëndësishme që AMF të ngrejë dhe forcojë kapacitetet e duhura në staf me ekspertizë në teknologji, për të qenë e aftë për të mbikëqyrur tregjet. Ashtu siç është diskutuar dhe në seksionin e mbikëqyrjes të këtij dokumenti, për një fazë të menjëhershme kjo mund të realizohet edhe duke marrë ekspertë të përkohshëm jashtë AMF-së, (mund të konsiderohet dhe nga jashtë Shqipërisë) të cilët do të ndihmojnë në ngritjen e një strukture me funksion mbikëqyrës, të fokusuar tek teknologjia.





## Fintech



Autoriteti i sheh zhvillimet e fundit në Teknologjinë Financiare si një evolucion pozitiv në përgjithësi përse kohë këto zhvillime shkojnë në përfitim të investitorit dhe konsumatorëve. Fintech dhe Inovacioni teknologjik kanë qenë arsyt kryesore të zhvillimit të tregjeve ndërkombëtare kohët e fundit në këto drejtime.

Inteligjenca Artificiale dhe Analiza e të Dhënave Komplekse (Big Data Crowdfunding)  
Zhvillimet në shërbimet “cloud”  
Zhvillimet në teknologjinë e “Blockchain”

Pavarësisht se zhvillimet e mësipërme do të përmirësojnë shërbimet dhe do të reduktojnë ndjeshëm koston për konsumatorët dhe investitorët, Autoriteti vë re se në disa prej tyre ka arsye për shqetësim në drejtim të transparencës dhe mungesës së kuadrit ligjor dhe rregullativ. Autoriteti po ndjek me shumë vëmendje zhvillimet e fundit në lidhje me emetimet e kriptomonedhave me ofertë fillestare (ICO), të cilat pavarësisht se lehtësojnë mënyrën e emetimit, duke i bërë të aksesueshme këto lloj investimesh për publikun e gjerë në mënyrë globale, paraqesin një sërë rreziqesh të cilat janë adresuar nga Autoriteti si dhe autoritetet homologe nëpërmjet deklaratave për shtyp.

Autoriteti e përkrah inovacionin si një e mirë e domosdoshme drejt zhvillimit ekonomik që do të rrisë produktivitetin dhe reduktojë koston ndjeshëm në të ardhmen. Por gjithashtu Autoriteti vëren se çdo inovacion duhet të shoqërohet me kuadrin përkatës rregullativ dhe ligjor, në mënyrë që investitorët të jenë të mbrojtur dhe tregjet të mirëfunksionojnë. Autoriteti synon që në drejtim të teknologjisë financiare gjatë pesë viteve të ardhshme të orientohet drejt:

- Monitorim i vazhdueshëm në lidhje me produktet e reja të Fintech në lidhje me tregun e titujve dhe sigurimeve.
- Monitorim i vazhdueshëm i zhvillimit të tregjeve të Fintech si dhe rreziqeve dhe përfitimeve që sjellin për konsumatorin shqiptar.
- Komunikim i vazhdueshëm me autoritetet homologe përse i përket trajtimit të çështjeve të ndryshme në lidhje me Fintech.
- Përmirësim i kuadrit ligjor dhe rregullativ për t'u adaptuar sa më mirë me ndryshimet e reja teknologjike.

## 2.3. Infrastruktura ligjore e tregjeve

### 2.3.1 Kuadri i përgjithshëm

Përpjekjet e AMF-së ndër vite për zhvillimin e kuadrit ligjor, kanë rezultuar në hartimin e ligjeve, pjesa më e madhe e të cilëve përafrojnë me standardet e Bashkimit Evropian. Legjislacioni shqiptar në fuqi për tregjet financiare jo bankare, synon kryesisht:

- ▶ eliminimin e pengesave për funksionim të efektshëm të tregut të brendshëm;
- ▶ promovimin e konkurrencës në treg;
- ▶ transparencën dhe mbrojtjen e konsumatorit etj.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit në nenet 102-104 të saj parashikon detyrimin për përafrimin e legjislacionit të brendshëm me *Acquis* të BE-së dhe harmonizimin me politikat e saj. Në përputhje me këto angazhime janë miratuar dhe hartuar një sërë ligjesh të rëndësishme, megjithatë plotësimi dhe përmirësimi i legjislacionit përkatës është i nevojshëm për t'iu përgjigjur zhvillimit dinamik të fushave specifike si dhe krijimit të tregjeve evropiane.



## 2.3.2 Tregu i sigurimeve



Shqipëria mbetet një ndër tregjet më të vogla të sigurimeve në botë. Tregu i sigurimeve nuk është i kompletuar në pikëpamjen rregullatore. Në një masë të konsiderueshme tregu funksionon mbi bazën e parametrave vetërregullues. Nëse në vendet e tjera evropiane, pas bankave, shoqëritë e sigurimeve janë aktorët, të cilëve u adresohet numri më i madh i akteve ligjore apo nënligjore që rregullojnë tregun, në Republikën e Shqipërisë situata në këtë drejtim nuk i është përgjigjur në mënyrë të duhur nevojës për zhvillim.

Duke nisur nga Kodi Civil, i cili është dokumenti bazë mbi të cilin zhvillohen marrëdhëniet kontraktore, rendi ligjor plotësohet me dy ligje specifike të cilat i adresohen rregullimit të tregut të sigurimeve. Ligji bazë i cili rregullon mënyrën e organizimit dhe funksionimit të shoqërive të sigurimit është **ligji nr.52, datë 22.05.2014 "Për sigurimin dhe risigurimin"**. Duke qenë një ligj kuadër dhe i përgjithshëm ky ligj përcakton rregulla bazë për kriteret, të cilat duhet të përmbushen nga shoqëritë e sigurimit, apo dhe për vetë rregullat e mbikëqyrjes. Ndërkohë ligji ka pak hapësira për transparencën ndaj konsumatorëve dhe të siguruarve, edukimin e publikut etj.

Këtij kuadri rregullator i atashohet edhe ligji nr.10076, datë 12.2.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve të transportit", i ndryshuar, i cili është i vetmi ligj që rregullon në mënyrë analitike dhe të detajuar funksionimin e njërit prej produkteve të tregut të sigurimeve, sigurimit të detyrueshëm motorik. Aktualisht sigurimi i detyrueshëm i përgjegjësishë në këtë ligj është parashikuar për automjetet, mjetet e transportit publik, mjetet ujore dhe mjetet ajrore. Janë pikërisht këto raste që dominojnë praktikën.

Nga një analizë e kujdesshme e tregut aktual në nivel rregullator, evidentohen disa veçori të problematikës së referuar: së pari, vihet re se problemet e mbartura mund të adresohen me anë të mekanizmave ligjore për forcimin e zbatueshmërisë së ligjit në praktikë, (*duke forcuar rolin e institucioneve përgjegjëse; duke saktësuar kompetencat mbikëqyrëse në zbatim, duke parashikuar sanksione në rast mospërbushjeje të detyrimeve ligjore*) etj. Nga ana tjetër, problematika e identifikuar në këtë dokument kërkon gjetjen e zgjidhjeve edhe nëpërmjet hartimit të normave të tjera rregullatore, veçanërisht si një proces i nxitur nga qasja progresive me legjislacionin e BE-së.

Mungesa e një legjislacioni stimulues për zhvillim të përshtatshëm të tregut, renditet si një nga problemet, që ka kushtëzuar edhe gjendjen aktuale të tij, pa anashkaluar edhe problematika të tjera si: mungesa e një platforme të qartë për zhvillimin afatgjatë të tregut; mbështetja në produkte të një natyre kryesisht motorike të detyrueshme; mungesa e iniciativave për transferimin e rrezikut, për mbrojtjen e individëve si dhe transparencës në shitjen dhe ndërmjetësimin e produkteve të sigurimeve; mungesa e kapaciteteve, etj.

Nën këtë ombrellë rregullatore aktuale të tregut të sigurimeve në Republikën e Shqipërisë evidentohen disa momente për t'u adresuar në mënyrë strategjike për vitet në vijim, më konkretisht:

*Mungesa e një kuadri të plotë e të unifikuar për sigurimin e përgjegjësive për dëmet që i shkaktohen palëve të treta nga veprimtaria e subjekteve të ndryshëm.*

Numri i sigurimeve të detyrueshme të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi është shumë i ulët, madje i papërfillshëm. Ky është një boshllëk ligjor i cili rrjedh nga mungesa e një kuadri ligjor efikas dhe të standardizuar për rregullimin e përgjegjësive ndaj palëve të treta. Aktualisht sistemi i brendshëm ligjor e adreson sigurimin e detyrueshëm në disa akte të niveleve të ndryshme rregullatore, ligje apo edhe akte dytësore të karakterit nënligjor ku rregullimi i përgjegjësisë civile nga ushtrimi i profesionit nuk paraqitet në mënyrë të plotë dhe të detajuar si në rastin e transportit rrugor, por vjen si një rregullim i shpërndarë në ligje të veçanta edhe në akte nënligjore. Kjo qasje legjislative reflekton problemet e veta gjatë zbatimit, të cilat konsistojnë në këto drejtime:

**1.** Mungesa e një akti të konsoliduar i cili të grupojë nga pikëpamja rregullatore tërësinë e rasteve të përgjegjësisë civile nga ushtrimi i profesionit, gjendje kjo e cila shoqërohet me këto efekte negative në zbatim:

**1.1** Shpërndarja e rasteve të përgjegjësisë civile përkundrejt palëve të treta në ligje të ndryshme, bën të vështirë orientimin e organeve ligjzbatuese për këto produkte;

**1.2** Rregullimi i shpërndarë i përgjegjësisë civile nga ushtrimi i profesionit, sjell si pasojë, mungesën e një autoriteti të vetëm rregullator të specializuar për mbikëqyrjen e produkteve të detyrueshme që mbulojnë këtë përgjegjësi, apo së paku mungesën e mekanizmave për bashkëpunim efektiv ndërmjet institucioneve përgjegjëse të fushës, ç'ka përbën premisë për rregullim dhe mbikëqyrje të diferencuar;

**1.3** Shpërndarja e kompetencave ndërmjet organeve të ndryshme shtetërore, me tipologji të ndryshme funksionale, vë në rrezik eficientësinë e tregut lidhur me ofrimin e këtyre produkteve;

**2.** Mungesa e mekanizmave ligjorë, që garantojnë zbatueshmërinë e detyrimit për sigurim duke konsideruar që sigurimi si më sipër parashtruar, gjykohet të jetë në nivelin 20-30% dhe shpeshherë është fiktiv.

**3.** Rregullimi me akt nënligjor i produkteve të detyrueshme, bie ndesh me rregullimet e Kodit Civil. Më konkretisht:

**3.1** Kontrata e sigurimit, si çdo kontratë tjetër, i nënshtrohet dispozitave të përcaktuara në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë apo në ligje të veçanta kur flasim për sigurimin e detyrueshëm. Kjo kontratë rregullohet në nenin 1113 dhe ato vijues të Kodit Civil. Në këto dispozita rregullohen elementët e përgjithshëm të kësaj kontrate, përkufizimi, palët dhe detyrimet respektive, ana formale dhe elementët përbërës të kontratës, vlefshmëria etj. Ç'ka do të thotë se qëllimi i ligjvënësit, në këtë rast është rregullimi me ligj i kësaj marrëdhënieje, dhe jo me akte nënligjore apo rregulla të tjera dytësore.

**3.2** Parashikimi me akte dytësore rregullatore, karakterizohet nga mungesa e forcës shtrënguese/detyruese, për shkak të mungesës së mekanizmave zbatues dhe sanksioneve përkatëse. Për vet natyrën e akteve nënligjore këto çështje të rëndësishme janë të përjashtuara nga fusha e tyre e mbulimit, në parim dhe për tipologji, sanksionet parashikohen vetëm në kuadër të një strukture të mirëfilltë ligjore.

Mungesa e dispozitave për sigurimin e detyrueshëm shtrihet edhe në një sërë aktiviteteve të tjera publike dhe tregtare, të tilla si: sigurimi i detyrueshëm i aksidenteve në punë; sigurimi i detyrueshëm i përgjegjësive publike dhe produktit; sigurimi i përgjegjësive publike për Hotele, Bare-Restorante, njësi të tjera shërbimi të këtij lloji; sigurimi i detyrueshëm i përgjegjësive ligjore të ndërtuesve; sigurimi i detyrueshëm i studentëve dhe nxënësve nga shëndeti dhe aksidentet etj.

Në një perspektivë të ardhshme rregullatore një listë bazë dhe efektive e sigurimit të përgjegjësive profesionale duhet të përfshijë ndër të tjera edhe sigurimin e përgjegjësive profesionale të mjekëve, dentistëve, farmacistëve, avokatëve, inxhinierëve, ekspertëve kontabël dhe kontabël të miratuar, veterinerëve, agronomëve etj., për dëmet që nga ushtrimi i veprimtarisë së tyre i shkaktojnë palëve të treta, etj.

Gjithashtu, në një qasje strategjike çmohet oportune hartimi i ligjeve integrale dhe uniforme për sigurimin e përgjegjësive për dëmet që i shkaktohen palëve të treta.

Gjithashtu, në nivel ligji vlerësohen me impakt pozitiv për tregun edhe përcaktimi në legjislacionin tatimor i heqjes së taksës së primit ose rivendosja në nivelet e mëparshme (3%) mbi produktet e sigurimit, heqja e tatimit mbi të ardhurën e përfitimit për sigurimin e Jetës, si dhe zbatimi i lehtësirave fiskale për pensionet private siç përcaktohen në legjislacionin përkatës; përmirësimi i dispozitave të Kodit Civil që rregullojnë kontratën e sigurimit; rishikimi i ligjit nr. 10076 date 12/02/2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”; hartimi dhe krijimi i strukturës së nevojshme për krijimin e qendrës së informacionit të mjeteve motorike për zbatimin e sistemit Bonus–Malus etj.

### 2.3.3 Vështrim krahasues në lidhje me problematikat e evidentuara më sipër.



Siç është referuar në mënyrë sistematike në këtë dokument, tregu i sigurimeve në vendet e Evropës Perëndimore dhe Rajonit është një treg i shëndetshëm dhe relativisht më i zhvilluar dhe kjo për dy arsye: e para, lidhet me faktin se ligjvënësi në mënyrë kapilare e ka rregulluar tregun e sigurimeve të detyrueshme, por edhe mbikëqyrur tregun e sigurimeve të krijuar nga shoqëritë; dhe e dyta, për faktin se operatorët e tregut kanë përkrahur vazhdimisht inovacionet, duke prodhuar gjithmonë produkte të reja por, mbi të gjitha duke kryer investime gjithmonë e më komplekse.

Përkundrejt listës së legjislacionit që rregullon tregun e sigurimeve, në Itali dhe Francë, rezulton se në Itali, sigurimet e detyrueshme janë një listë e gjatë duke përfshirë profesione nga ato më klasiket deri te profesionet më të reja të zhvilluara në kohë: si noterët, agjentët e sigurimeve, mjekët, pronarët e impianteve të skive, teleferikët, ofruesit e shërbimeve të praktikës profesionale, organet që çertifikojnë produktet për tregtim, shoqëruesit teknikë në garat çiklistike, organet që çertifikojnë aparaturat për diagnostikim in vitro, gjuetarët, etj.

Në këtë optikë është e qartë se dallimi kryesor qëndron në faktin se sigurimet e detyrueshme në Shqipëri janë në disbalancë të plotë në raport me vendet e tjera të referuara në mënyrë krahasimore.

### 2.3.4. Tregu i Pensioneve Vullnetare

Ligji bazë në fuqi i cili përcakton skemën e pensioneve në Shqipëri është ligji 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar).

Sipas këtij ligji, pjesë e kësaj skeme është edhe sigurimi vullnetar, i cili paraqitet në këtë renditje në sistemin e përgjithshëm të Sigurimeve Shoqërore:

Aktualisht, sistemi shtetëror i sigurimeve shoqërore jo vetëm në Shqipëri por edhe në shumë vende të tjera evropiane e me gjerë, si rrjedhojë e prishjes së disa ekuilibrave, veçanërisht demografik (*plakjes së popullsisë*) po kalon një periudhë të shoqëruar me mjaft probleme, veçanërisht për sa i përket financimit të këtij sistemi. Në kërkim të zgjidhjes së tyre, organizma ndërkombëtare, si FMN, Banka Botërore etj, kanë orientuar në ndërmarrjen e reformave për të rritur qëndrueshmërinë financiare të sistemit. Sot problemet e pensioneve dhe sidomos defiçitetet financiare të skemës së pensioneve shtetërore, përbëjnë një shqetësim evident edhe në vendin tone. Kjo ndër të tjera edhe si rrjedhojë e ritmeve me të cilat rritet popullsia e tretë, por bazuar edhe në elementë të tjerë të tillë si rritja e jetëgjatësisë së popullatës dhe rënia e lindshmërisë.

Këto situata kanë shtruar nevojën e reformimit të sistemit të pensioneve, duke u fokusuar në gjetjen e rrugëve të përshtatshme dhe të drejta të financimit, duke krijuar përgjegjësi të përbashkët të mbulimit të nevojave jetësore në pleqëri, midis shtetit dhe individit.

**Inkurajimi i skemave vullnetare suplementare të pensioneve** mund të influencojë në dy drejtime:

- a) në mundësimin e pensioneve shtesë mbi ato që jep sistemi i detyruar shtetëror dhe
- b) në ofrimin e kushteve më të favorshme për pensionet në raport me ato që ofrohen nga skema bazë.

Këtu mund të përfshihen kategori punonjësish, si minatorë, metalurgë etj, pra kategori të punëve të vështira. Kjo skemë kërkon vlerësim të kujdesshëm nga pikëpamja fiskale me qëllim funksionimin e saj në mënyrë efektive dhe me interes veçanërisht për përfituesit.

**Rishikimi i legjislacionit për skemat suplementare të pensioneve të nëpunësve shtetërorë.** Kjo skemë mund të funksionojë si kolonë e tretë dhe të administrohet nga Fondet e Pensioneve Vullnetare.



### 2.3.5. Tregu i letrave me vlerë



Ligji kuadër i cili rregullon tregun e titujve është ligji nr.9879, datë 21.2.2008 “Për titujt”. Objekti i këtij ligji konsiston në percaktimin e llojeve të titujve, rregullon mënyrën dhe kushtet për emetimin e titujve, tregtimin dhe regjistrimin, identifikimin dhe kryerjen e transaksioneve me to, përcakton personat dhe individët e autorizuar për kryerjen e transaksioneve me titujt, kushtet për organizimin e tregtimit publik të titujve, mbrojtjen e investitorëve dhe të mbajtësve të të drejtave mbi titujt, kushtet për dematerializimin e titujve, organizimin e funksionimit dhe regjistrave të titujve, shkëmbimin dhe rregullimin e tregut të titujve.

Ndërsa rendit përkatës ligjor, i atashohen edhe ligje specifike me një fushë më të kufizuar veprimi. Kështu, ligji nr.10158, datë 15.10.2009 "Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore", i cili ka si qëllim përmirësimin e bazës ligjore, zhvillimin e tregut të kapitaleve dhe mbrojtjen e investitorëve, zbatohet vetëm për obligacionet e shoqërisë aksionare, me zyrë qendrore në Republikën e Shqipërisë dhe qeverisë vendore. Obligacionet e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë apo të Bankës së Shqipërisë, janë të përjashtuara nga zbatimi i këtij ligji.

Ligji tjetër që plotëson skemën aktuale rregullatore është ligji nr.10 236, datë 18.02.2010 "Për marrjen në kontroll të shoqërive me ofertë publike". Ky ligj përcakton rregullat, që lidhen me kushtet dhe procedurat për marrjen në kontroll të shoqërive me ofertë publike dhe zbatohet për ofertat e shpallura publikisht për marrjen në zotërim të titujve, të emetuar nga një shoqëri publike, me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe të pranuar për tregtim në tregun e organizuar të titujve të Republikës së Shqipërisë, sipas ligjit nr. 9879, datë 21.2.2008 “Për titujt”, dhe nga shoqëritë publike të huaja, me seli brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të listuara në bursë në Shqipëri. Ky ligj nuk zbatohet për ofertat për marrjen në zotërim të titujve të emetuar nga shoqëritë, objekti i të cilave



është investimi kolektiv i kapitalit të siguruar nga publiku, që ushtrojnë veprimtari në bazë të parimit të shpërndarjes së rrezikut dhe kuotat e të cilave riblihen ose shlyhen, me kërkesë të mbajtësve të tyre, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga pasuritë e këtyre shoqërive. Ky ligj nuk zbatohet për titujt e emetuar nga Banka e Shqipërisë.

Në rrjedhë logjike të problematikës së parashtruar në kapitullin pararendës, çmohet e nevojshme që në plan rregullator të hartohet një ligj i ri “Për titujt” në përputhje me Acquis të BE-së dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, i cili të reflektojë sugjerimet e mëposhtme, por pa u kufizuar në to:

- ▶ Mbrojtja e konsumatorit;
- ▶ Rregullimi mikro-prudencial;
- ▶ Rehabilitimi dhe zgjidhjet;
- ▶ Rreziku sistemik;
- ▶ Zhvillimi i tregut etj.

Përveç komponentëve të mësipërm, rritja financiare dhe ekonomike dhe zhvillimi i tregut duhet të lehtësohen mbi një bazë të shëndoshë ligjore ç’ka kërkon përputhshmëri me Direktivat e BE-së dhe qasjen e IOSCO-s. Kur ligjet e miratuara nga Parlamenti orientohen në nivelin e parimeve dhe nuk përfshijnë detaje specifike, ato mbeten në një masë të madhe relativisht të pandryshueshme. Parimet lidhen me botën në zhvillim të vazhdueshëm të tregjeve financiare nëpërmjet dy metodave: **rishikimin e vazhdueshëm të legjislacionit dytësor/aktet nënligjore të hartuar nga rregullatori dhe interpretimi nga gjyqësori.**

Kjo qasje ka funksionuar mirë me shumë tregje të zhvilluara ku ligjet kanë artikuluar parime të gjera që nuk ndryshojnë me rritë financiare apo teknologjike. Rregullatorët më tej hartojnë dhe miratojnë legjislacion dytësor që është në formën e rregulloreve të hollësishme. Ky legjislacion i deleguar do të modifikohet shpesh nga rregullatorët, prandaj mund të përshtatet vazhdimisht me inovacionin financiar dhe teknologjik. Ky kombinim i legjislacionit primar dhe atij të deleguar/nënligjor formon një mekanizëm që zhvillohet pa probleme me kalimin e kohës. Në të kundërt, nëse karakteristikat e detajuara të produkteve dhe proceseve financiare janë futur në ligj, kërkesa për ndryshime të shpeshta në ligj do të pengonte progresin. Duke ndjekur qasjen e bazuar në parime, gjithashtu përmirësohet ndjeshëm kultura e përputhshmërisë, pasi këto janë të kuptueshme dhe të lehta për tu ndjekur.

### 2.3.6. Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive



Ligji nr. 10 198, datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", është ndryshuar me ligjin nr. 36, datë 31.03.2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10 198, datë 10.12.2009, "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive".

Ky ligj ka për qëllim të rregullojë kushtet dhe kriteret për themelimin, regjistrimin dhe funksionimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, si dhe të shoqërive administruese, stukturat e fondeve me pjesëmarrje të hapur e pjesëmarrje të mbyllur që ofrohen dhe shiten; emetimin dhe shitjen e kuotave dhe të aksioneve; shlyerjen e kuotave; promovimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive; veprimtaritë e kryera nga palët e treta për llogari të sipërmarrjeve të investimeve kolektive; realizimin e mbikëqyrjes, nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, të veprimtarisë së sipërmarrjeve të investimeve kolektive të shoqërive administruese, depozitarëve dhe të personave të përfshirë në shitjen e kuotave e të aksioneve, që duhet të mbikëqyren sipas këtij ligji; veprimtarinë e sipërmarrjeve të huaja të investimeve kolektive dhe të shoqërive administruese të huaja në Republikën e Shqipërisë; vendosjen e rregullave, që sigurojnë funksionimin e drejtë të tregut të kapitaleve dhe nxitjen e lëvizjes së lirë të tyre.

Ligji i sipërmarrjeve të investimeve kolektive është hartuar duke përdorur si bazë ligjin kroat për fondet e investimeve. Ligji kroat që nga ajo kohë, natyrisht ka ndryshuar duke marrë parasysh zhvillimet si në Bashkimin Evropian ashtu edhe në Kroaci, por struktura e saj themelore është e njëjtë. Pra, për rrjedhojë ligji shqiptar përfaqëson me Direktivat e Bashkimit Evropian deri në kohën kur është hartuar, por mund dhe duhet të përditësohet për çdo shtojcë apo ndryshim të mëtejshëm që nga ajo kohë.

Direktiva e Menaxhimit të Fondit të Investimeve Alternative ('AIFMD') duhet të merret parasysh për fondet e mbyllura të cilat mbulohen nga kjo direktivë.

Megjithëse kuadri rregullator është ndryshuar së fundmi, problemet e reflektuara në praktikë dhe qasja më standardet e BE-së evidentojnë nevojën për ndërhyrje legjislative në këtë fushë. Konkretisht, legjislacioni i ri duhet të adresojë problematikat e mëposhtme por pa kufizuar vetëm në to:

► Mungesa në ligjin ekzistues e hapësirave ligjore për të hedhur në treg fonde të reja me një natyrë më të larmishme sesa ato ekzistuese. Megjithëse ligji (neni 56) përmend fondet ombrellë dhe fondet furnizuese, kërkesat e operatorëve në treg nuk gjejnë mbështetje ligjore për një procedurë eventuale të miratimit nga AMF-ja për lançimin e fondeve të reja siç mund të jenë fondet *Master-Feeder* ;

► Ligji kufizon investimin në kuota të fondeve të tjera të investimit në nivelin 30% të asetëve (neni 88, pika 7/a). Ky kufizim e bën të pamundur krijimin e strukturave të tilla si "fond i fondeve", të cilat janë shumë të përhapura në tregje të tjera sepse garantojnë diversifikim të rrezikut duke shmangur ekspozimin ndaj emetuesve individualë. Ligji ekzistues jo vetëm nuk e përmend fare konceptin e "fondeve të fondeve", por në mënyrë indirekte e bën të pamundur krijimin e një fondi të tillë përmes kufizimit prej 30%.

► *Detyrat e Bankës Depozitare/Kujdestarit*

Megjithëse në ligj përmenden detyrat themelore të bankës depozitare, bazuar në shqetësimet e ngritura nga tregu lidhur me tarifatat që u imponohen investitorëve të fondeve në rast shlyerjesh, detyrat e bankës depozitare duhet të jenë më të qarta, me qëllimin për të shmangur paqartësitë dhe abuzimin e investitorëve.

► *Kostot që lidhen me fondin e investimit.*

Sipas ligjit, neni 90, pika 3, nuk lejohet vendosja e tarifave për rezultatet e veprimtarisë së fondit. Në një vlerësim të bazuar edhe në eksperiencën e vendeve të zhvilluara, lejimi i tarifave të performancës (performance fee-s) do të mundësonte vendosjen e tarifave më të ulëta të menaxhimit dhe fondi mund t'u ngarkonte investitorëve tarifa shtesë vetëm nëse arrihen nivele të caktuara përfitueshmërie.

- 
- ▶ Një boshllëk specifik është përcaktimi i investitorit profesional apo të sofistikuar në krahasim me investitorët institucionale.
  - ▶ Identifikimi i rregulloreve të shumta në zbatim të ligjit, përbën problem në orientim. Shumë çështje rregullatore imponojnë nxjerrjen e një numri të madh rregullash në zbatim të ligjit. Këto ndonjëherë janë të vështira për t'u gjetur dhe mund të bien ndesh me njëra-tjetrën. Mund të jetë e vlefshme që të kesh një “libër rregullash” të konsoliduar për fondet e investimeve që sjellin të gjitha ndryshimet që ndodhin. Kjo mund të shfaqet në faqen e internetit. Kjo është shumë më e lehtë për përdoruesit të cilët mund të jenë të sigurt se edicioni i fundit i librit të rregullave është definitiv. Është gjithashtu më e lehtë për rregullatorët pasi ata nuk do të kenë nevojë të tërheqin vazhdimisht vëmendjen e industrisë në rregulloret e reja. Libri i fundit i përmirësuar i rregullave mund të publikohet në faqen e internetit.
  - ▶ Së fundmi është e rëndësishme, siç është praktika e Autoritetit në të gjitha rastet e ndryshimeve në ligje ose rregullore të reja të ndërmarren konsultime të plota të industrisë para se të futen rregulloret e reja; një konsultim i tillë duhet gjithashtu të lejojë një periudhë të arsyeshme për përgjigje. Në këtë drejtim, aty ku ka më shumë kompani të administrimit, një shoqatë tregtare është një zhvillim i dobishëm.



### 2.3.7. Përmirësimi i kuadrit ligjor në fuqi



Ligji përbën një nga instrumentet kryesore për implementimin e strategjisë. Në këtë kuptim çështjet të cilat janë evidentuar në kapitujt paraardhës dhe analizës ligjore të përshkruar do të adresohen nëpërmjet një plani të detajuar të veprimit, që do të pasojë miratimin e strategjisë. Kjo veprimtari do të konsistojë në përmirësimin e kuadrit ligjor nëpërmjet hartimit të akteve të reja ligjore apo amendimi i atyre ekzistuese:

Për pjesën më të madhe, pesëvjeçari i ardhshëm do të jetë një vit i ndryshimeve në legjislacion në lidhje me tregjet e kapitalit, me qëllim transpozimin e ligjeve të reja evropiane ose për shkak të nevojës për një legjislacion më të mirë për fusha të caktuara financiare. Këto ndryshime do të rikonfigurojnë kuadrin ligjor aktual.

Një objektiv tjetër për vitet në vijim konsiston në fillimin e procesit të transpozimit të direktivës mbi aktivitetet dhe mbikëqyrjen e Institucioneve për Sigurimin e Pensioneve Profesionale - *IORP II Directive*.

Për sektorin e sigurimeve dhe risigurimeve, korniza ligjore do të plotësohet me dispozita të reja me qëllim transpozimin e disa direktivave të BE-së.

**Më konkretisht**, ndërhyrjet ligjore mund të përmbliidhen si më poshtë, por pa u kufizuar në to:

- ▶ Rishikimi i ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”;
- ▶ Rishikimi i ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”;
- ▶ Ligji i ri “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”;
- ▶ Ligji i ri “Për titujt” duke përfshirë edhe obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore;
- ▶ Hartimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjeve të reja të miratuara;
- ▶ Kryerja e procesit Screening i cili përfshin analizën e të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë shërbimet financiare jo bankare për tre fushat dhe përcaktimin e shkallës së përputhshmërisë të tyre me Acquis të BE-së (*direktiva, rregullore, vendime, udhëzime, vendime të Gjykatës Evropiane*), si dhe nenet përkatëse të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian;

Implementimi i legjislacionit përkatës të BE-së ku më me përparësi mbetet për afrimi i:

- ▶ Direktivës Solvency II;
- ▶ Direktivës MIFID II;
- ▶ Direktivës UCITS (2009);
- ▶ Direktivës Market Abuse;
- ▶ Direktivës 2016/97 etj.
- ▶ Rishikimi i legjislacionit për të siguruar mbrojtje më të gjerë të të drejtave të konsumatorit;
- ▶ Hartimi i një legjislacioni të unifikuar për mbulimin e përgjegjësisë civile përkundrejt palëve të treta;
- ▶ Hartimi dhe përmirësimi i kodeve të sjelljes për institucionet financiare dhe ndërmjetësit.



### 2.3.8. Konsolidimi i akteve dytësore.

Sasia numerike e rregulloreve imponon rishikim të legjislacionit drejt një sistemimi tematik të akteve në fuqi. Shumë çështje kërkojnë nxjerrjen e një numri të madh rregullash në zbatim të ligjit. Këto ndonjëherë janë të vështira për t'u gjetur dhe mund të kenë premisë për të kundërshtuar njëra-tjetrën. Mund të jetë e dobishme dhe e vlefshme që të hartohet një akt i konsoliduar rregullash për tregun e titujve, tregun e sigurimeve dhe tregun e pensioneve vullnetare, i cili sjell në kohë dhe të azhornuara ndryshimet që ndodhin. Ky dokument i konsoliduar mund të shfaqet në faqen e internetit dhe mund të jetë shumë i lehtë për tu përdorur. Nëpërmjet një konsultimi të tillë përdoruesit mund të jenë njëkohësisht të sigurt se janë njohur me versionin e fundit të azhornuar të kuadrit rregullator.





amf

amf

amf







